

SHITBLERJET(SALES AND BUYES):

ADRESA E PRONARIT DHE FIRMA
(ADDRESS OF OWENER AND SIGNATURE):

ADRESA E POSEDUESIT DHE FIRMA
(ADDRESS OF POSSESSOR AND SIGNATURE):

PRONARI I RI (NEW OWNER):

SKEDUESI (COMPILER): SILVA BRESHANI

DATA (DATE): 05/09/2007

KOMISIONI I VLERËSIMIT (COMMISSION OF ASSESSMENT):

- 1.
- 2.
- 3.

DREJTOR
(DIRECTOR)

Në bazë të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeet", objekti klasifikohet pasuri kulturore.
(According to Law 27/2018 "On Cultural Heritage and Museums", the object is cultural property.)

Lëvizja e objektit shqërohet vetëm me lejen e Ministrisë së Kulturës. (The movement of the object should be executed only upon the permission of the Ministry of Culture)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRY OF CULTURE



INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE
NATIONAL INSTITUTE OF CULTURAL HERITAGE REGISTRATION

Pronari (Owner) SHETETI
Poseduesi(Possessor) INSTITUTI I MONUMENTEVE
KULTURORE

ID: 0001
ID:

Drejtori i IKRTK(Director of NICHR)
Tel: +355(4) 22 269 03
Web: www.ikrtk.gov.al

Vula (Seal)

CERTIFIKATË OBJEKTI

NUMËR (NUMBER): 31405

VENDNDODHJA (LOCATION):

Sheti (State): Shqipëri Qarku (Region): Qark Rrethi (District): Qytet

Qytet/Fshat(City/Country): Diber Rruga (Street): -

FUSHA (DOMAIN): ARKITEKTURE


KATEGORIA (CATEGORY): Objekte Kult

TIP (TYPE): Kishë

TITULLI (TITLE): Kisha e Shën Sotirit (Sveti Spas), Diber

MATERIALI (MATERIAL):Gur

FOTOGRAFIA E OBJEKTIT 6 me 9 (cm)
(PHOTOGRAPHY OF OBJECT 6 by 9 cm)



Nr. i Regjistrimit (No. of Register):

237

Nr. i Inventarit (No. of Inventory):

KATALOGU (CATALOGUE)

==



TË DHËNAT KRYESORE TË OBJEKTIT
MAJOR DATA OF THE OBJECT.

TEKNIKA (TECHNIQUE): E perzier
KULTURA (CULTURE): Shqiptare
PERIUDHA (PERIOD): Mesjetë e Vonë (-)
AUTORI (AUTHOR): ANONIM ANONIM
PËRMASAT (DIMENSIONS):
Gjatësia (Length): 7.58 **Gjerësia (Width):** 4.7 **Lartësia (Height):** 4.7
Njësia (Unit): METER
PESHA (WEIGHT):
VLERË (VALUE): 0 Lek
DORËZUESI (DELIVERER):

PËRSHKRIMI (DESCRIPTION):

Kisha është e vogël njëqetëshe e mbuluar me qemer cilindrik gjatesor. Në interior ruan pikturë murale, ka një ndërtim të thjeshtë, pronas-naus-abside,ka një dritare në mes të absides.Në mure ruhen afreske të dendur me permasa 7x3.4m. Muratura gure të lidhur me llaç e gëlqere,çatia e mbuluar me rrasa guri.

Kisha e Shen Sotirit (Sveti Spas) ndodhet në fshatin Kercisht i Epërm të Komunës Maqellare të rrethit të Dibres. Kisha njihet edhe me emrin Sveti Spas.Në distance 500m nga ky monument por në kute me të lartë ndodhet Kisha e Sh.Dhimitrit.Kisha e Shen Sotirit (Sveti Spas) duke u krahësuar me kishën e Sh.Dhimitrit si në zgjidhjen planimetrike, në kompozimin volumor, në tekniken e ndërtimit të muveve tregon se është ndërtuar shumë me parë se ajo.(Në muret e Kishës së Sh.Dhimitrit është gdhendur vitit 1892). Ky monument mendohet të jetë ndërtuar gjatë shekullit 16-te.

Kisha e Sh.Sotirit është një kishë e vogël njëqetëshe me permasa të brendshme 3.4x6.3m. Nga ana strukturore kisha paraqet një zgjidhje të thjeshtë.Një çift pilastrash nxjerrë në muret gjatesore formojnë arkade (me dy harqe) ngjitur me keto mure, mbi të cilën mbeshetet qemeri cilindrik i pandërprerë gjatë gjithë aksit gjatesor të kishës.Çatia e kishës është dyjese me kostruksion druri,mbuluar me rrasa guri.Pjesa lindore përmban ambjentin e altarit nga e cila del absida trefaqeshe.Protezisi dhe diakonikoni janë gjithashtu të formuar dhe të pajisur me nlike. Altari ndahet nga naosi me një ikonostas të druajtë.Dyshemeja është realizuar me pllaka guri me ngjyrë të çelët.Dyshemeja e naosit është 20cm më poshtë se niveli i pragut të hyjes. Muratura e kishës është ndërtuar me gure potuajse të papunuar lidhur me llaç gëlqere.Interieri i kishës është i dekoruar me pikturë murale. Kisha është pak e ndriçuar, ka një ehapje (fregji) shumë të vogël në fasaden veriore dhe një dritare në fasaden perendimore e hapur me vone dhe pa kujdes.

Në përgjithësi gjendja statike e monumentit paraqitet e mirë. Problemi kryesor në këtë monument është çatia. Konstruksioni i drurit të saj është i amortizuar. Ka depërtim të lageshtë, gjë që rrezikon pikturën murale në muret e brendshme të monumentit. Ka mungesë të theksuar të rrasave të gurit që mbulojnë çatinë si pasojë e rënies dhe thyerjes së tyre.Në muret perimetrale të kishës nuk paraqiten çarje apo inklinime.Si pasojë e ndërhyrjeve në vite,fugaturat duke mos u realizuar me cilësi dhe me të njëjten teknikë me muratën origjinale,japin idene e ndërtimit të kishës në disa faza, gjë e cila nuk faktohet. Dyshemeja, përgjithësisht paraqitet në gjendje të mirë.Ka disa mungesa të pllakave të gurit në 10% të sipërfaqes së saj. Kisha ruan ende derën e saj origjinale.Elementet e drurit të portës paraqiten në gjendje të amortizuar.Ambjenti rrethues, kisha ndodhet në ane të rrugës së fshatit (në një nivel me të ulët se rruga), në një territor të pjerrët. Ky ambjent paraqet i pasistenuar përsa i përket orientimit të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësor. Nuk ka asnjë rrugë të sistenuar që të çon në hyrjen e kishës.Në këtë monument mungon tabela përshkuese e informacionit mbi vlerat e monumentit si dhe elementet mbrojtës kundër rrezikut të zjarrit.

TË DHËNAT TË TJERA (OTHER DATA):

RESTAURIMI: Çdo lloj ndërhyrje, kush e ka bërë, si dhe rilevimi topologjik i objekteve të paluajtshme.

(RESTORATION): Any kind of restoration work; the person(s) that have carried it out, as well as the topographic survey of immovable objects.

Vendim Nr. 5, dt. 04.06.2009

Ne mbeshetje te nenit 17, pika 6, te ligjit nr. 9048, date 27.07.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt. 28.02.2008, "Per Trashegiminë Kulturorë", Keshilli Kombetar i Restaurimeve ne mbledhjen e dates 04.06.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara ne Institutin e Monumenteve te Kultures

Vendosi:
Sipas pikave te rendit te dites:
1. Te miratoje projektet e restaurimit te financuara nga buxheti i shtetit.
2. Miratohet: Restaurimi dhe konsolidimi i pikturës murale ne Kishen Sveti Spas, Kerçisht, Peshkopi.
Plotei kartelen: Ferdinand Yzeiri
Dt. 03.07.2015 kartela e DRKK Shkoder

SHKALLA E DËMTIMIT (SCALE OF DAMAGE): 4

1. Shumë Mirë; ... 10. Shumë Keq (1. Very Good; ... 10. Very Bad)

ORIGINAL/KOPJE (ORIGINAL/COPY): Original

VEND ORIGJINA (ORIGIN PLACE):

VENDI I RUAJTJES (STORAGE LOCATION):

TRASHËGIMI (HERITAGE): Po

HISTORIKU: Ku dhe kur është zbuluar, kur ka marrë statusin e trashëgimisë kulturore.

(HISTORIC INFORMATION): Place and date of discovery, date of gaining the status of cultural heritage.

Shpallur monument kulture me Urdhëresën e Ministrisë së Arsimit dhe Kultures (Drejtoria e Kultures) Nr.68/1 Prot, dt.30.05.1970

LËVIZJET E OBJEKTIT (MOVEMENTS OF OBJECT):

BIBLIOGRAFIA (BIBLIOGRAPHY):

Monumente.
Dosja e restaurimit te monumentit 2007 me autore:
Ing. Kozeta Angjeliu
Ark. Lujçiano Bojaxhiu
Urb. Marsela Pylku